



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Sipas vendimit të Këshillit Drejtues të datës 12/10/2022, Oda e Avokatëve të Kosovës shpallë:

K O N K U R S
- për vend të lirë të punës -

Duke i bërë publike dhe të arritshme për të gjithë:

I. Vendi i punës:
Asistent Administrativ;

II. Kushtet:

Përveç kushteve të përgjithshme ligjore për themelimin e marrëdhënies së punës, kandidati duhet t'i plotësojë edhe këto kushte, në lidhje me kualifikimet:

- Shkolla e mesme;
- (1) vjet përvojë pune administrative;
- njohje e gjuhëve zyrtare në Kosovë;

III. Përshkrimi i punëve:

Asistenti administrativ kryen këto punë dhe detyra të punës:

- mban agjendën e Kryetarit dhe të Drejtorit ekzekutiv
- përgatit takimet në OAK
- Pranimin dhe dorëzimin e Postes
- ndihmon stafin administrativ në kryerjen e punëve teknike,
- fotokopjon materiale
- bënë fajllimin e dokumenteve të OAK
- Protokollimin e shkresave
- përgjigjet në telefonatat e OAK
- njohja e punës me kompjuter programet Word, Excel
- kryen edhe punët tjera me të cilat e ngarkon Drejtori ekzekutiv apo Kryetari

Te kandidatët do të vlerësohen edhe: kreativiteti, shkathtësitë profesionale, aftësia për të përballuar punën nën presion.

IV. Paga:

Koeficienti i pagës: 5.0

V. Dokumentacioni dhe procesi i përzgjedhjes:

Kandidatët të cilët dëshirojnë të paraqiten në konkurs, duhet të sjellin këto dokumente:

- Aplikacionin (i cili plotësohet në OAK me rastin e dorëzimit të dokumenteve);
- Diplomën dhe dokumentet e tjera që dëshmojnë kualifikimet profesionale;
- Dëshmi të përvojës së punës;
- Letër-motivuese të shkurtër (prej rreth 1 faqe)

Kandidatët e zgjedhur për intervistë do të informohen për datën dhe vendin e mbajtjes së intervistës nga OAK.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Odën e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, Rr. Bekim Fehmiu pn. (Ndërtesa Arting), Kati IV.

VI. Afati i Konkursit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentacioni i pakompletuar dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim, sikur edhe ata kandidatët të cilët nuk i përgjigjen ftesës për intervistim dhe nuk i nënshtrohen procesit të përzgjedhjes.

Informatat:

Për informata më të hollësishme të interesuarit mund të lajmërohen në: 038/244-586 dhe e-mail: info@oak-ks.org